

UNIVERSITETI AAB

FAKULTETI EKONOMIK



PUNIM I MASTERIT

Efektet e transaksioneve elektronike me fokus në luftimin e informalitetin: Trendet e realizimit të transaksioneve elektronike në Kosovë

Studenti: Blina Zhubi

Prishtinë, Prill 2019

Përmbajtja

1. HYRJE	3
1.1. Qëllimi i punimit.....	4
1.2. Objektivat	4
1.3. Pyetjet e punimit.....	5
1.4. Rëndësia e temës	5
2. RISHIKIMI I LITERATURËS MBI INFORMALITETIN	6
2.1 Definimi i informalitetit	6
2.2 Manifestimi i informalitetit	8
2.3 Informaliteti në Kosovë	9
3. PARAJA ELEKTRONIKE: LLOJET, PËRPARËSITË DHE MANGËSITË	11
3.1 Rishikimi i literatures mbi tansaksionet elektronike dhe paranë e gatshme	11
Fig 1. Mjetet e pagesave elektronike në Ballkanin Perëndimor	12
3.2. Llojet e parasë elektronike	13
3.3. Përparësitë dhe mangësitë e parasë elektronike	13
Tabelë 1. Avantazhet dhe disavantazhet e parasë elektronike	14
4. PARAJA ELEKTRONIKE NË KOSOVË	14
5. ROLI I PARASË ELEKTRONIKE NË ULJEN E INFORMALITETIT	16
5.1. Rëndësia e redukimit të transaksioneve me para të gatshme dhe ekonomia vendore.....	16
5.2. Lufta kundër informalitetit përmes krijimit të një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave.....	17
5.3 Përdorimi i parasë kesh dhe elektronike në Kosovë	20
5.4. Pagesat elektronike në Kosovë dhe vendet e rajonit.....	23
6. Përfundimet	25
7. Rekomandimet	27
8. PRAKTIKË	28
8.3. Fushata: Reduktimi i transaksioneve me para të gatshme në Kosovë	28
Literatura	29

1. Hyrje

Me zhvillimin e teknologjisë u mundësua dhe u zhvillua një aspekt i ri në perceptimin dhe përdorimin e parasë. Përkundër faktit se paraja e gatshme akoma është mjete më i përhapur i pagesave, mënyra tradicionale e përdorimit të parasë ka pësuar ndryshime. Pagesat sot bëhen duke përdorur para të gatshme, kartela apo transferet bankare. Dallojmë dy grupe kryesore të instrumenteve të pagesave; në letër dhe elektronike. Instrumentet letër janë: paraja e gatshme, çeku, urdhërtransferet dhe urdhërpagesat në letër etj; ndërsa shembull i formës së përdorimit të parasë elektronike janë: kartelat bankare, pagesat përmes internetit, paraja elektronike, e-banking, pagesat përmes telefonit, urdhërpagesat elektronike, paraja virtuale, etj. Këto dy forma të parasë shndërrohen në njëra tjetrën. Njeriu sipas nevojës tërheq para nga llogaria e tij dhe i merr ato si para të gatshme, gjithashtu kur ka në posedim para të gatshme duke i deponuar ato në llogarinë e tij ai i përdor ato pastaj si para elektronike. Paraja elektronike ofron lehtësira për përdoruesit sepse eliminon nevojën për bartje të monedhave dhe kursen kohën që përndryshe do të ishte shfrytëzuar për të shkuar në bankë për të tërhequr para. Si rezultat zvogëlohet ekspozimi ndaj rrezikut të humbjes së parasë, grabitjes, falsifikimit, mashtrimit etj. Transaksionet elektronike u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara të kryejnë veprimet e nevojshme financiare pa pasur nevojë, që fizikisht të jenë në bankë apo të ngarkojnë dikë tjetër për këtë. Përparësi tjetër është se paraja elektronike është më e sigurt, e pa dëmtueshme sepse nuk griset, laget, shlyhet, me kalimin e kohës, etj. Thënë ndryshe, përdorimi i parasë elektronike ofron më tepër lehtësi, shpejtësi, efikasitet dhe efektshmëri në kryerjen e transaksioneve dhe qasje globale.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është përgjegjëse për licencimin, regjistrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare që veprojnë në Republikën e Kosovës ashtu siç specifikohet më tej me ligjet përkatëse¹. Në të njëjtën kohë, BQK

¹ Banka Qendrore e Kosovës - www.bqk-kos.org . Ligji Nr. 03/L-209 "Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", Kreu VIII, Neni 23.1.

është ekskluzivisht përgjegjëse për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë në Republikën e Kosovës.²

Përkundër rritjes ekonomike gjatë dekadës së fundit, niveli i papunësisë dhe varfërisë mbetet i lartë në Kosovë. Rritja ekonomike kryesisht është stimuluar nga remitancat dhe donacionet dhe misionet ndërkombëtare në Kosovë. Ani pse nuk ka matje zyrtare të informalitetit, disa përpjekje për të matur informalitetin tregojnë se Kosova ka nivel të lartë të informalitetit. Sipas vlerësimit të Agjencisë Evropiane për Rindërtim (AER) në vitin 2007, madhësia e ekonomisë joformale në Kosovë varioje midis 27 dhe 35 % të BPV-së në periudhën 2004-2006 (ILO, 2010). Të gjeturat e Riinvest (2013)³ gjithashtu tregojnë se informaliteti në aspektin e mungesës së deklarimit të shitjeve të biznesit dhe punonjësve vlerësohet të jetë më shumë se 30 për qind (Riinvest, 2013). Kjo sugjeron që të ardhurat buxhetore janë mbi një të tretën më pak se vlerat aktuale dhe si rezultat, mbi 30 për qind më pak shërbime publike të ofruara dhe shkalla e papunësisë më e ulët se ajo e raportuar zyrtarisht.

1.1. Qëllimi i punimit

Qëllimi parësor i këtij punimi është që të analizojë praktikën e përdorimit të transaksioneve elektronike në Kosovë, rëndësinë, përfitimet që ofron për individin, biznesin dhe shtetin. Në veçanti punimi synon të analizojë rolin e stimulimit të transaksioneve elektronike dhe reduktimin e pagesave me kesh në luftimin e informalitetin.

1.2. Objektivat

Objektivat e këtij punimi janë:

- Të shqyrtoj literaturën për të analizuar definimin e transaksioneve elektronike dhe indikatorët që përdoren në literaturë.
- Të analizoj llojet e transaksioneve elektronike dhe përfitimet që ofron për individët, bizneset dhe shtetin.

² Banka Qëndrore e Kosovës - www.bqk-kos.org

³ Abdixhiku, L. Pugh, G. and Hashi I. (2013). Determinants of Business Tax Evasion in Transition Economies: A Panel Investigaiton. Working Paper

- Të analizoj lidhshmërinë teorike mes përdorimit të pagesave elektronike dhe uljen e informalitetit.
- Të analizoj strukturën institucionale dhe kornizën ligjore për realizimin e transksioneve elektronike dhe luftimin e informalitetit në Kosovë.

1.3. Pyetjet e punimit

Pyetjet e këtij punimi janë:

1. Çfarë nënkuptohet me transaksione elektronike dhe cilët janë indikatorët që përdoren në literaturë?
2. Cilat janë përfitimet e transaksioneve elektronike për individët, shtetin dhe biznesin?
3. A ekziston një lidhje teorike në mes të rritjes së përdorimit të transaksioneve elektronike dhe reduktimin e pagesave me kesh në luftimin ekonomisë joformale?
4. Çfarë është ndërmarrë deri më tani për të stimuluar përdorimin e transaksioneve elektronike dhe reduktimin e përdorimit të keshit në Kosovë?
5. Cili është trendi i përdorimit të transaksioneve elektronike dhe indikatorëve të informalitetit në Kosovë ndër vite dhe a ka indikacione se ekziston lidhshmëri mes këtyre të dyjave?

1.4. Rëndësia e temës

Përfitimi nga përdorimi i kartelave bankare të llogarisë rrjedhëse në kryerjen e transaksioneve bankare është i shumë anshëm, meqenëse është në dobi të të gjitha palëve të përfshira. Në radhë të parë përfiton qytetari pasi eliminohet nevoja të bartë me vete shuma të mëdha të kesh-it, zvogëlohet rreziku i ballafaqimit me para të falsifikuara, për më shumë kartelat bankare janë shumë të sigurta dhe të lehta në përdorim. Gjithashtu, të gjitha transaksionet regjistrohen në raportin e bankës në mënyrë që blerësit të mund të mbajnë evidencë të saktë për shpenzimet e tyre⁴.

⁴Albanian Center for Economic Research. (1999) Informal Economy in Albania: Study of Hidden Employment and Tax Evasion, ACER.

Një nga arsyt ekonomike pse duhet reduktuar keshi është sepse 2 % e GDP- së së Kosovës dëmtohet duke e menaxhuar keshin. GDP totale e Kosovës është 7 miliard dollar dhe 2% e 7 miliardve është kosto për të menaxhuar keshin. Duke bërë një llogaritje të tillë 140.000.000 milion dollar dëmtim i kushton Kosovës. Pra, një prej arsyeve kryesore pse vendet mundohen të reduktojnë paranë e gatshme është informaliteti, pasiguria në transaksione dhe po ashtu sulmet e ndryshme që po afektojnë bankat.

Studimet e fundit tregojnë se ekonomia e Kosovës ka nivel mjaft të lartë të ekonomisë jo formale me rreth 31.7%⁵. Realizimi i transaksioneve elektronike më konkretisht përdorimi i kartelës bankare ose transfereve bankare kontribuon në luftimin e ekonomisë së ‘zezë’, meqenëse çdo transaksion bankar regjistrohet dhe në këtë formë bizneset obligohen të paguajnë tatimet ndaj shtetit. Në këtë mënyrë, përmes përdorimit të transaksioneve bankare, qytetari ndihmon në mbushjen e arkës së shtetit. Përmes kësaj, përfiton gjithë ekonomia e vendit dhe shoqëria në përgjithësi, meqenëse kjo nënkupton më shumë buxhet për vendin dhe më shumë mundësi për të investuar në mirëqenien e qytetarëve (në çerdhe, shkolla apo edhe institucione tjera shërbyese për komunitetet tona. Ekonomistë të njohur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar mendojnë se një botë pa para të gatshme është e dëshirueshme e mundur dhe do të ishte një veprim i zgjuar.⁶

2. RISHIKIMI I LITERATURËS MBI INFORMALITETIN

2.1 Definimi i informalitetit

”Termi“ informalitet” për herë të parë është përdorur në vitin 1970 për të përshkruar aktivitetet ekonomike që zhvilloheshin jashtë rregullit shtetëror (Rinvest, 2013). Megjithatë, fenomeni social i punësimit jo-formal ekzistonte edhe më herët. Edhe pse marrëdhëniet e punës jo formale nuk janë kritikuar në atë kohë, kishte disa hulumtues social të cilët shkruanin për aktivitetet ekonomike jo formale, duke përmendur, për shembull, zbavitësit e rrugës, tregtarët, apo punëtorët nëpër disa fabrika.

“Informaliteti është një fenomen global mjaft i përhapur, i cili është bërë tipar i shteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Pavarësisht nga shtrirja globale, dhe pavarësisht nga efektet negative që ka,

⁵ Intervistë me Zyrar të Shoqatës së Bankave

⁶ Interviste me Zyrar të Shoqatës së Bankave


informaliteti përsëri mbetet term që shkakton debat që drejtpërdrejt lidhet me definicionin e tij, klasifikimin dhe matjen” (Riinvest, 2013, fq.7).

Shqyrtimi i literaturës së fundit, që mundohet ta definojë informalitetin, na sjell tek pyetja e shpeshtë se a duhet ky koncept të përfshijë të dyja aktivitetet, ato “ligjore” dhe “jo-ligjore”. Aktivitetet ligjore përfshijnë aktivitetet biznesore të përgjithshme, të cilat kur zihen mund të formalizohen (pasi ta marrin dënimin), por nuk shuhet; p.sh. këto aktivitete mund të sjellin të ardhura shtesë në buxhet. Aktivitetet jo-ligjore, në anën tjetër, përfshijnë aktivitetet të cilat nuk duhet ekzistuar; si trafikimi i qenieve njerëzore apo i drogës. Këto aktivitete, kur zihen, pushojnë së ekzistuari dhe nuk sjellin të hyra shtesë në buxhet (Riinvest, 2013).

Sipas punimit të Riinvestit, në definimin e ekonomisë jo formale (e quajtur edhe ekonomia hije, ekonomia paralele, ekonomia e nëndheshme, ekonomia jozyrtare) përfshihen njësi të vogla të angazhuara në prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve dhe që nuk janë të regjistruara si njësi formale. Poashtu përfshihen njësi që funksionojnë në prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve, që janë të regjistruara si njësi formale, por që deklarojnë vetëm pjesërisht vëllimin e aktivitetit të tyre, janë njësitë prodhuese ose të shërbimeve që krijohen në bazë familjare dhe gjithnjë të përgjithshme. Ata janë shpesh persona fizikë që, ushtrojnë aktivitetin e tyre pa licencë dhe disa autorë si shtojcë të veçantë përfshijnë edhe veprimtaritë ekonomike të ndaluara me ligj dhe ato kriminale (Ibid).

Sipas raportit të Bankës Botërore, (Job Diagnostic Kosovo) matja e informalitetit është sfiduese, por mbi një e katërta e të punësuarve në Kosovës vlerësohet të jenë në sektorin informal. Përcaktimi i informalitetit është problematik dhe ekzistojnë konceptime të shumfishta. Përkufizimi kryesor në këtë seksion është se ajo përbëhet nga punëtorët e pa pages të familjes, punëtorët e vetëpunësuar në ndërmarrjet e vogla, punëtorë të pavarur në profesione joprofesionale, punëtorë në ndërmarrje të vogla (pesë ose më pak punonjës). Pjesa tjetër (65.2 % të të punësuarve), numërohen si punëtorë të sektorit formal, por të dhënat mund të jenë jo të besueshme, sepse ka nën-raportim substantial të të ardhurave për të shmangur taksat - një fenomen i njohur si "paga e zarfit" në Evropën Lindore (World Bank, 2017).

Figure 4-18
Percentage of firms in Kosovo that complain that they are "majorly" or "severely" affected by competition from informal sector firms is one of the highest in the world



Source: Authors' calculations using BEEPS (circa 2013) and WDI (GDP per capita in 2013, PPP (constant 2011 international \$)).

Burimi: *World Bank (Jobs Diagnostic Kosovo)*

Taksat e punës dhe kontributet janë relativisht të ulëta, por bizneset joformale kanë gjasa të nxjerrin një avantazh duke shmangur taksat dhe rregulloret. Pjesa e shitjeve që nuk raportohen tek autoritetet tatimore është më e lartë tek bizneset e vogla se sa tek ato të mëdha (Rinvest, 2013). Për shkak se bizneset e vogla kanë më shumë gjasa të jenë joformale, sinjalizon që bizneset joformale përfitojnë një avantazh nga nën-raportimi i rregullimit të shitjeve. Është e mundur që këto biznese të kenë një nxitje më të madhe për të nën-raportuar shitjet e tyre për të mos u regjistruar për TVSH (World Bank, 2017).

Ekonomia informale gjithashtu shkakton deficit buxhetor dhe zvogëlon të mirat publike andaj lind nevoja për hartimin e strategjive për ndërhyrjen dhe luftimin e informalitetit (ASK, 2013)⁷.

2.2 Manifestimi i informalitetit

Bernabe (2002), propozoi katër nënkategori të informalitetit të cilat janë prezente në vendet në zhvillim dhe të cilat janë relevante edhe për Kosovën.

- Aktivitetet joformale, të cilat ndërmerrën për të përmbushur nevojat themelore;
- Veprimtaritë nëntokësore, të cilat janë fshehur qëllimisht nga autoritetet publike për të shmangur pagesën e taksave ose pajtueshmërinë me disa rregullore;
- Aktivitete të paligjshme, të cilat gjenerojnë mallra dhe shërbime të ndaluara nga ligji ose që janë të paligjshme kur kryhen nga prodhuesit e paautorizuar;

⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2013). Produkti i Brendshëm Bruto për aktivitete 2006 – 2012. Cituar tek (Strategjia kombëtare e R. Kosovës 2014- 2018, fq 24).

- Aktivitetet e ekonomisë familjare, të cilat prodhojnë mallra dhe shërbime për konsum personal;⁸ (Bernabe)

Aktiviteti informal raportohet të jetë prezent tek të dy grupet e puntorëve, të vetpunësuarit si dhe të punësuarve në organizata të ndryshme. Gjithsesi argumentohet se të vetpunësuarit apriori janë të prirur të operojnë në mënyrë informale. Puna informale më së shumti shfaqet tek i vetëpunësuarit sepse si rrjedhojë do e ketë mos pagimin e tatimeve.

Rishikimi i literaturës sugjeron se informaliteti manifestohet në mënyra të ndryshme:

- Mosdeklarimit të punëtorëve,
- Mos deklarimi i pagave;
- Transaksionet e shumta me kesh (si rezultat mos deklarimi i qarkullimit) të cilat mundësojnë që informaliteti të jetë në norma të larta;
- Mbajtja e shumë vendeve të punës;
- Punonjësit jo të rregullt (punësime të kohë pas kohshme dhe pa kontratë);
- Punët ilegale;
- Të punësuarit në mënyrë të rastësishme, përkohësishtë ose sezonale⁹ (Kingslow, 2002)

Disa nga mënyrat e manifestimit të punësimit informal janë:

- Pagat me kesh (në zarf) dhe mos pagimi i tatimeve dhe kontributeve;
- Punësimi jo i deklaruar;
- Deklarim i pjesërishtëm (pjesa tjetër në zarf)
- Puna në vikend dhe pagesa bëhet me kesh, ku si pasojë nuk deklarohen tatimet.¹⁰ (Bernabe)

2.3 Informaliteti në Kosovë

Sipas vlerësimit të Agjencisë Evropiane për Rindërtim (AER) në vitin 2007, madhësia e ekonomisë joformale në Kosovë variante midis 27 dhe 35 % të BPV-së në periudhën 2004-2006 (ILO, 2010). Të

⁸ Bernabe_Informal_Employment_Transition_Countries

⁹ Kingslow (2002). Informal_Economy_Lit_Review

¹⁰ Bernabe_Informal_Employment_Transition_Countries

gjeturat e Riinvest (2013) gjithashtu tregojne se informaliteti në aspektin e mungesës së deklarimit të shitjeve të biznesit dhe punonjësve vlerësohet të jetë më shumë se 30 për qind (Riinvest, 2013). Kjo sugjeron që të ardhurat buxhetore janë mbi një të tretën më pak se vlerat aktuale dhe si rezultat, mbi 30 për qind më pak shërbime publike të ofruara dhe shkalla e papunësisë më e ulët se ajo e raportuar zyrtarisht. ¹¹(Riinvest, 2013). Gjithashtu, bizneset e vogla dhe të mesme janë në gjendje të involvohen në evazion fiskal më tepër sesa të mëdhat.

Lidhur me evazionin në fuqinë punëtore, të anketuarit besojnë se mesatarisht bizneset raportojnë 63 % të fuqisë së tyre punëtore. Kjo do të thotë që 37 % të fuqisë punëtore në Kosovë mbetet e padeklaruar ose e pa regjistruar. Evazioni i fuqisë punëtore dallon nga sektori në sektor. Ky është kryesisht evident në sektorin e bujqësisë, ndërsa sektori më pak evaziv është ai i edukimit. Sektori i bujqësisë ka ndërrimin më të madh të fuqisë punëtore, për shkak të ndryshimeve sezonale, andaj kjo shpjegon nivelin e ulët të deklarimit të punëtorëve. ¹² (Ibrid)

Raporti i Bankës Botërore tregon që Kosova ka një nga normat më të mëdha të informalitetit në ECA (Eastern Europe and Central Asia). Punësimi informal në Kosovë është më i lartë se në shumicën e shteteve të BE. Informaliteti në Kosovë është prapa vetëm Greqisë dhe Qipros. Sipas raportit të Bankës Botërore normat e informalitetit në Kosovë janë rreth dy herë më të larta se normat në Belgjikë dhe Holandë.

Kosova vazhdon të njihet si një vend i “ekonomisë së parave të gatshme”. Përkundër ekzistimit të një sistemi modern bankar, që mundëson kryerjen e transaksioneve elektronike, paraja e gatshme vazhdon të përdoret masovikisht nga shumica e qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës.¹³ (Naim Huruglica (2017). Sipas artikullit të Naim Huruglicës, përdorimi kaq i madh i parave të gatshme e bën të vështirë edhe ndalimin e futjes së parave të pista në kuadër të ekonomisë (shpëlarjes së parasë), pasi kjo paraqet mënyrën më të lehtë për t’i futur në qarkullim paratë e fituara nga krimi i organizuar. Shfrytëzimi më i madh i sistemit bankar për realizimin e transaksioneve dhe pagesave nga individët dhe kompanitë do të mundësonte në masë të madhe zvogëlimin e ekonomisë informale.¹⁴ (Naim Huruglica, 2017)

¹¹Instituti Riinvest. (2013). Të paguash apo të mos paguash | Informaliteti nga këndvështrimi i bizneseve në Kosovë

¹² Ibid fq.31

¹³ Naim Huruglica (2017). Sistemi Bankar dhe Luftimi i Informalitetit

¹⁴ Naim Huruglica (2017). Sistemi Bankar dhe Luftimi i Informalitetit

Sistemet e zhvilluara të pagesave elektronike kanë ndikim të madh edhe në rritjen e transparencës dhe fuqizimin e mekanizmave të monitorimit të sistemeve të taksave. Në këtë drejtim, një ndër përparësitë kryesore të reduktimit të transaksioneve në para të gatshme është edhe zvogëlimi siq njihet “ekonomia jo-formale” e cila ka pasoja të mëdha negative për ekonominë e një vendi. Këto pasoja kryesisht mund të përmblihen në zvogëlimin e bazës së tatimit, zvogëlimin e kualitetit dhe kuantitetit të produkteve dhe shërbimeve për publikun, dëmtimin e konkurrencës së drejtë të tregut, degradimin e institucioneve ekonomike dhe sociale, rrjedhimishtë ndikmin direkt në kufizimin e rritjes ekonomike të një vendi. Prandaj, është shumë më rëndësi për të gjitha këto kategori, si individet, bizneset, bankat dhe institucionet shtetërore që të punojnë në zvogëlimin e përdorimit të parave të gatshme dhe të avancojnë më tutje me rritjen e përdorimit të pagesave përmes instrumenteve elektronike.¹⁵ (Revista, TKB)

3. Paraja elektronike: Llojet, përparësitë dhe mangësitë

3.1 Rishikimi i literatures mbi transaksionet elektronike dhe paranë e gatshme

Në nivel global, paraja e gatshme përbën rreth 85% të transaksioneve të përgjithshme, ndërsa në vendet e Bashkimit Monetar Europian kjo pjesëmarrje është më e ulët, në rreth 79%. Supozohet që kjo % të jetë edhe më e lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor, në rreth 90%. Këto të dhëna tregojnë se paraja e gatshme (cash) ende dominon bindshëm në përdorimin e tij si mjet pagese nga konsumatorët. Megjithatë, ka dallime në mes shteteve të ndryshme, sa i përket nivelit të përdorimit të parasë së gatshme. Madje, ka dallime edhe në mes të gjinive dhe grup - moshave të cilat janë identifikuar në studime të kryera nga Banka Qëndrore Evropiane. Bazuar në studimin e Tufts University, Fletcher School and Steinbeis University Research Center for Financial Services rezulton se, vendet nordike, si: Suedia dhe Finlanda, kanë nivelin më të ulët të përdorimit të cash-it, në më pak se 45%. Në një prizëm interesant, studimet tregojnë se meshkujt përdorin cash si mjet pagese më shpesh se femrat, si dhe është e evidente që moshat më të vjetra përdorin cash në frekuencë më të shpeshtë se të rinjtë.¹⁶

Sjellja dhe kultura financiare e një shoqërie ka ndikim të madh në përdorimin e mjeteve të pagesave, por një faktor tjetër i rëndësishëm është edhe qasja në terminale të pagesave elektronike, si dhe siguria dhe

¹⁵ Revista "The Kosovo Banker"

¹⁶ Tufts University, Fletcher School and Steinbeis University Research Center for Financial Services

kostoja e tyre. Në Ballkanin Perëndimor numri i kartave bankare dhe llogarive e-banking nuk dallon shumë nëse merret parasysh madhësia e popullsisë, siç shihet nga figura 1. Dallimi më i madh shihet në kartat e debitit dhe POS-et ku Kroacia dhe Serbia kanë një numër dukshëm më të lartë, ndërsa vendet e tjera të rajonit janë të përafërta.¹⁷ (Tafts University).

Fig 1. Mjetet e pagesave elektronike në Ballkanin Perëndimor

	ATM	POS	e-banking	kartela krediti	kartela debiti
Kosova	522	10,589	230,905	156,437	856,718
Shqipëria	800	7,111	209,157	85,537	871,511
Serbia	2,983	84,412	-	991,522	5,806,688
Bosnja	1,512	26,324	383,761	-	-
Mali i Zi	388	12,289	109,988	39,633	421,666
Kroacia	4,543	106,081	-	141,119	6,872,982
Maqedonia	1,039	34,974	695,220	375,854	1,443,022

Figura 1. Mjetet e pagesave elektronike në Ballkanin Perëndimor

Paraja në ditët e sotme është ajo që ekonomistët e përkufizojnë si “mjet pagese”, të cilin ne e shkëmbejmë për të mirat dhe shërbimet që blejmë. Njëkohësisht, paraja është njësi llogaritjeje dhe ruajtëse e vlerës. Paraja sot merr forma të ndryshme fizike. Këto forma përfshijnë monedhat, kartëmonedhat dhe llogaritë rrjedhëse pranë bankave tregtare. Me zhvillimin e njerëzimit paraja ka ndryshuar deri në ditët e sotme. Kambiali, çeku, letër debi, urdhërpagesa, urdhërpagesa periodike, janë mënyra tradicionale të zëvendësimit të parasë. Sot me zhvillimin e teknologjisë, informatikës dhe telekomunikimeve janë në dispozicion mënyra të tjera, të cilat mundësojnë transferim pa përdorimin e parasë së gatshme. Emëruesi i përbashkët i këtyre formave bashkëkohore është paraja elektronike.

Paraja elektronike i gjen fillimet në gjysmën e dytë të viteve '80 në Japoni. Shumëkush mund të mendojë që paraja elektronike ka lindur si nevojë e bankave tregtare. Në fakt, pionierët e parë të krijimit të kësaj paraje ishin disa kompani jobanka, të tilla si kompanitë telefonike apo kompanitë e transportit. Arsyet kryesore të hedhjes në treg të këtij produkti ishin zëvendësimi i parasë cash dhe përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve, duke fituar kështu besimin e tyre. Në vitin 1987, filluan të krijoheshin ndërmarrje të përbashkëta midis kompanive jobanka, të cilat prodhuan një kartë të përbashkët, e pranueshme në të gjitha degët e këtyre kompanive.

¹⁷ 2017 Artikuj të ndryshëm nga BQE, Esselnic dhe Hernandez

Paraja elektronike definohet si vlerë monetare e ruajtur në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën magnetike, siç paraqitet nga kërkesa ndaj emëtuesit, që emëtohet pas pranimit të fondeve me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe e cila pranohet, si mjet i pagesës nga personat e tjerë përveç emetuesit¹⁸. (Raport i Sistemit të Pagesave, BQK)

3.2. Llojet e parasë elektronike

Në përgjithësi, dallohen dy lloje të parasë elektronike: ajo e cila mund të identifikohet dhe paraja elektronike e paidentifikueshme (anonime). Paraja elektronike e identifikueshme përmban informacion mbi identitetin e personit, i cili ka tërhequr paratë nga banka. Paraja e identifikueshme i jep mundësi bankës “të gjurmojë” paranë, teksa qarkullon nëpër ekonomi. Për shembull, kur kryhen pagesa elektronike duke përdorur një kartë krediti, banka është në gjendje të identifikojë pagesën e kryer dhe në këtë mënyrë, mund të reduktojë shumën e paguar nga llogaria juaj bankare. Paraja elektronike anonime funksionon njësoj si paraja cash. Në momentin që paraja elektronike anonime tërhiqet nga banka nëpërmjet një llogarie bankare, ajo shndërrohet në para cash (para prej letre) dhe mund të shpenzohet pa lënë asnjë gjurmë të transaksionit të kryer.

3.3. Përparësitë dhe mangësitë e parasë elektronike

Ashtu si paraja cash, edhe paraja elektronike argumentohet të ketë përparësitë dhe mangësitë e saj. Sikurse paraja prej letre, paraja elektronike mundëson blerjen e të mirave dhe shërbimeve, huamarrjen dhe kursimin. Komoditeti është përparësia kryesore që ofron paraja elektronike. Ajo zëvendëson nevojën për të mbajtur me vete para cash. Këto para, tashmë janë në formën e një llogarie bankare ose të një karte krediti, në pritje për t'u tërhequr apo përdorur nga konsumatori. Një tjetër lehtësi që ofron kjo para është dhe kursimi i kohës për të shkuar në bankë, dhe për të tërhequr para apo për të kryer transfertat të shumave të ndryshme. Gjithashtu, paraja elektronike në ndryshim nga paraja letër, është e padëmtueshme sepse ajo nuk griset, nuk laget dhe nuk prishet me kalimin e kohës. Me krijimin e parasë elektronike shumë banka kanë nxjerrë produkte të ndryshme në treg, nëpërmjet të cilave të gjithë kanë mundësi të transferojnë fonde nga një llogari bankare në tjetrën, të blejnë artikuj të ndryshëm në internet, të paguajnë faturat e ujit, të dritave, të telefonit etj.

¹⁸ <https://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemilPagesave/>

Me gjithë të mirat që ofron paraja elektronike, ajo ka edhe disavantazhet e saj. Disa prej tyre përfshijnë mashtrimin, dështimin e teknologjisë dhe pasigurinë që u jep njerëzve. Një prej shqetësimeve më të mëdha është që falsifikatorët mund të krijojnë llojin e tyre të parasë elektronike, e cila do të ishte e padallueshme nga paraja e vërtetë. Këto probleme duhet të merren parasysh, në mënyrë që të fitohet besimi i publikut. Rritja e pakontrollueshme e përdorimit të parasë elektronike mund të vërë në rrezik sistemet e kontrolluara të parasë, duke i dhënë kështu dorë të lirë sistemeve joefikase. Në një sistem të pakontrolluar pagesash elektronike, pastrimi i parasë dhe evazioni fiskal mund të përhapen me shpejtësi. Kështu, është e rëndësishme që autoritetet të monitorojë qarkullimin e parasë, për të zbuluar këto aktivitete të paligjshme. Nga ana tjetër, transaksionet nëpërmjet parasë elektronike janë pothuajse “të padukshme” në sytë e njerëzve, krahasuar me transaksionet, të cilat kryhen në para cash. Duke mos patur mundësi t’i shohin këto transaksione në momentin që ato kryhen, njerëzit kanë tendencën të kenë një ndjenjë pasigurie për to. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur avantazhet dhe disavantazhet e parasë elektronike, sipas aktorëve kryesorë në sistemin e pagesave elektronike¹⁰.

Tabelë 1. Avantazhet dhe disavantazhet e parasë elektronike

Aktorët kryesorë	Efektet pozitive	Efektet negative
Rregullatorët	Më e kontrollueshme në momentin e kryerjes së transaksionit	Nuk lë gjurmë Evazion fiskal Kudër rregullator në lëvizje
Emetuesit	Tregje të reja dhe fitimprurëse	Falsifikim
Klientët	Më praktike në përdorim	Mungesë e mbrojtjes së anonimitetit të klientit
Tregtarët	Hyrje në tregjet globale Efikasitet në veprime	Falsifikim

¹⁰ Burimi : <https://www.bankofalbania.org/>

4. PARAJA ELEKTRONIKE NË KOSOVË

Është fakt që ekonomia botërore kohëve të fundit ka lëvizuar drejtë një ekonomie moderne dhe globale. Një prej faktorëve kryesorë që ka ndikuar në globalizimin e ekonomive është edhe rrjeti dhe sistemi ndërkombëtar i pagesave që mundëson qarkullimin e parasë kudo në glob. Platformat e pagesave digjitale në Kosovë përbënë një ekosistem të rëndësishëm për të mundësuar realizimin e pagesave me

kesh dhe jo kesh.

Dy prej parakushteve të një ekonomie pa kesh janë:

1. Qasja në financa – nëse banorët e një shteti nuk do të kishin llogari bankare dhe qasje të lehtë dhe jo të kushtueshme në financa nuk do të mund të flisnim për digjitalizim dhe reduktim të keshit. Ku ky kusht në Kosovë plotësohet më së miri. Kosova sot raporton rreth 2 milion llogari bankare ku përfshihen të gjitha tipet e llogarive bankare (llogari rrjedhëse, kursime dhe depozita).
2. Rrjeti i komunikimit që mundëson transaksionet digjitale është rrjeti i internetit. Ne e dimë që Kosova ka një rrjet të zhvilluar të internetit 4G.

Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka raportuar se gjatë vitit të kaluar se ka pasur rritje të pagesave përmes instrumenteve elektronike, gjë që ka ndikuar në zvogëlimin e pagesave me para të gatshme. Sipas raportit të BQK-së për vitin 2017, nga të dhënat statistikore për vitin e kaluar vërehet rritje në numër dhe vlerë të kredit transfereve, të cilat paraqesin një alternativë për pagesa pa para të gatshme. Me rritje të dukshme të përdorimit janë karakterizuar edhe pagesat përmes instrumenteve elektronike siç janë: transaksionet përmes debit kartelave, kredit kartelave dhe e-bankingut, duke ndikuar në zvogëlim të pagesave në para të gatshme. Gjatë vitit 2017, nëse krahasohet me një vit më parë, numri i transaksioneve me kartela është rritur për 9.5%, ndërsa vlera e tyre ka një rritje prej 30.7%, duke vijuar me trendin rritës të vërejtur gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, edhe transaksionet përmes e-banking janë rritur për 17.7%, në krahasim me vitin paraprak. ‘Prirja gjithnjë e më rritje e përdorimit të e-banking lidhet ngushtë edhe me përmirësimin e infrastrukturës, si dhe mundësive për t’u qasur në e-banking edhe përmes aplikacioneve në telefon mobil’, thuhet mes tjerash në raportin e BQK-së.¹⁹ (BQK)

Sipas Shoqatës së Bankave të Kosovës, sistemi i pagesave në kuadër të industrisë bankare ka shënuar progres të mirë ndër vite, qoftë kjo përmes rritjes së numrit dhe vlerës së pagesave, e po ashtu edhe përmes zgjerimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga kjo industri, duke bërë kështu që shfrytëzimi i shërbimeve elektronike në Kosovë të rritet në mënyrë të ndjeshme. Drejtues së Shoqatës së Bankave të Kosovës, thonë se momentalisht, diku rreth 90% të shërbimeve bankare në disa banka në Kosovë, raportohen se kryhen përmes shërbimeve elektronike. Sipas tyre, për më shumë, industria bankare në Kosovë në përputhje edhe me strategjinë kombëtare për reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme është duke ofruar gjithnjë e më shumë produkte dhe shërbime të reja elektronike, që nënkupton

¹⁹ Banka Qëndrore e Kosovës & Intervistë me zyrtarë të Bankave

se klienti gjithnjë e më pak ka nevojë që të shkoj fizikisht tek degët bankare për të kryer një shërbim bankar, duke mundësuar kështu që këto shërbime t'i realizoj nga shtëpia (përmes e-banking), apo drejtpërdrejt nga vendi ku klienti e merre produktin apo shërbimin (P.sh. përmes POS apo ATM).²⁰ (Interviste- SHBK)

5. ROLI I PARASË ELEKTRONIKE NË ULJEN E INFORMALITETIT

5.1. Rëndësia e redukimit të transaksioneve me para të gatshme dhe ekonomia vendore

Ky kapitull analizon të dhënat, studimet, rezultate të anketave apo burimeve tjera relevante rreth përdorimit të transaksioneve elektronike dhe indikatorëve të informalitetit për të shqyrtuar nëse trendet e këtyre indikatorëve japin indikacione përlidhshmërinë mes trendit të përdorimit të transaksioneve elektronike dhe nivelit të informalitetit në Kosovë. Duhet theksuar se ky punim nuk synon të analizoj në mënyrë empirike ndërlidhjen në mes të përdorimit të transaksioneve elektronike dhe informalitetit në Kosovë.

Një nga dukuritë negative në Ballkanin Perëndimor, që funksionon dhe rritet përmes përdorimit të cash-it, është evazioni fiskal, apo ekonomia gri. Informaliteti ekonomik i lartë paraqet një të metë të madhe në mundësitë e një vendi për të zhvilluar një treg të lirë dhe të barabartë, si dhe redukton mundësitë e shtetit për të ofruar shërbime cilësore dhe transformuese për shoqërinë. Evazioni fiskal nga operatorë të papërgjegjshëm ekonomik e shtrembëron tregun e lirë, duke i pamundësuar bizneseve të ndershme që të rrisin pozitën e tyre në treg. Gjithashtu, evazioni fiskal i mohon mundësinë banorëve të një vendi që të kenë infrastrukturë më të mirë, arsim dhe shëndetësi më cilësore, pasi qeveria qendrore apo pushteti vendor nuk e vjel tatimin legjitim nga këto biznese. Një prej mundësive më të mira për të parandaluar dhe luftuar këtë dukuri është promovimi i përdorimit të mjeteve elektronike të pagesave, si: kartat bankare, transaksionet me e-banking, si dhe mobile banking.²¹ (Revista Bankieri)

²⁰ Intervistë me zyrtar të Shoqata e Bankave të Kosovës

²¹ Revista Bankieri. www.aab.al. fq 15

Një ekonomi e tregut është më efikase dhe e aftë për të gjeneruar rritje ekonomike nëse shteti ndërhyt sa më pak në sektorin privat. Por, roli i shtetit është i pashmangshëm për të stimuluar krijimin e ndërmarrjeve konkurruese në sektorët me vlerë të lartë të shtuar. Industrinë e tilla bëjnë që rritja ekonomike të prodhojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. E ardhmja e zhvillimit të Kosovës varet nga fushëveprimi dhe produktiviteti i ndërmarrjeve. Pagesa me kartelë përveç që është një metodë shumë e lehtë e pagesës ajo gjithashtu zvogëlon mundësitë e rreziqeve dhe situata të padëshiruara të cilat i sjellë pagesa me para kesh, raste të tilla si mos kthimi i kusurit, të hollat e falsifikuara ose humbja e parave. Në momentin e pagesës me kartelë, qytetari kontribon në përmirësimin e të ardhmes së tij duke ndikuar në ndalimin e krimit që krijohet me përdorimin e parave kesh. Gjithashtu me përdorim të kartelës për pagesa parandalohet shmangia e tatimet rrejdhimisht ndikon në uljen e informalitetit. Tatimet që do të paguajnë bizneset do të ndihmojnë që të rritet buxheti i shtetit gjegjësishtë të investohet më shumë në investime kapitale dhe në sektorë si arsimit dhe shëndetësia.

Studimet tregojnë që përdorimi i parasë së gatshme ka një kosto ekonomike dhe reduktimi i parasë së gatshme ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike të shtetit. Kjo është mënyra më e mirë që të kontribuojmë për shtetin duke e mbushur arkën e shtetit. Pra reduktimi i transaksioneve me kesh do të ndikojë në mbushjen e arkës së shtetit.²² (Interviste)

5.2. Lufta kundër informalitetit përmes krijimit të një agjencie të vetme për mbledhjen e të hyrave

Një sërë kërkimesh akademike kanë argumentuar se reduktimi i informalitetit duhet të bazohet në një strategji të mirëstuduar, duhet të jetë afatmesme dhe afatgjatë, të synojë fokusimin te lehtësimi, të jetë integrale dhe të përfshijë sa më shumë faktorë dhe aktorë të zhvillimeve ekonomike dhe sociale²³. (Arben Malaj, fq 44)

Ekonomia informale paraqet një problem që është prezent tek një numër i madh i vendeve, por është i shfaqur sidomos tek vendet më pak të zhvilluara dhe atyre në tranzicion, ku as Kosova nuk bën

²² Interviste me zyrtarët të Bankave

²³ Formalizimi i Ekonomisë Prof. Asoc. Dr. Arben MALAJ INSTITUTI PËR POLITIKA PUBLIKE DHE MIRËQEVERISJE (IPPM) fq 44

përjashtim. Ekzistojnë faktorë të ndryshëm që nxisin paraqitjen, gjegjësisht lejojnë ekzistimin e ekonomisë informale.²⁴ (Huruglica, 2017). Disa nga këta faktorë janë:

- Mungesa e një administrate efikase tatimore;
- Mungesa e një sistemi adekuat tatimor;
- Niveli i lartë i tatimeve;
- Korrupsioni;
- Mungesa e besueshmërisë tek institucionet qeveritare dhe dyshimet për keqmenaxhim të fondeve publike;
- Niveli i ulët i edukimit të taksapaguesve, etj.²⁵

Edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për shkallën e prezencës së saj, niveli i informalitetit në Kosovë mbetet i lartë, rreth 26-34% të GDP-së.²⁶ Sipas disa të dhënave të publikuara, vlerësohet se së paku 30% e aktiviteteve biznesore nuk raportohen për qëllime tatimore. Po ashtu vlerësohet se edhe tregu informal i punës vazhdon të jetë i lartë, duke vazhduar ta punësojë një numër të madh të punëtorëve të paregjistruar dhe të padeklaruar për qëllime tatimore.²⁷ (Huruglica, 2017)

Qeveria e Kosovës ka hartuar Strategjinë për Luftimin e Ekonomisë Joformale që do ti përfshijë këto masa që të ndërmerren me qëllim të luftimit të ekonomisë jo-formale:

- 1.) Prezantimi i pakos së re tatimore, duke synuar nxitjen e bizneseve të veprojnë në sektorin formal të ekonomisë;
- 2.) Fuqizimi i kapaciteteve institucionale si ATK, Doganat dhe institucionet tjera të cilat e mbikëqyrin funksionimin e bizneseve;
- 3.) Rritje e bashkëpunimit institucional për të siguruar se bizneset operojnë në sektorin formal;
- 4.) Bashkëpunimi ndër-institucional për të arritur konvergjencën graduale të proceseve dhe integrimin pasues të dy institucioneve. Identifikimi i proceseve identike, të ngjashme dhe ato të

²⁴ Naim Huruglica (2017). Sistemi Bankar dhe Luftimi i Informalitetit

²⁵ Naim Huruglica (2017). Sistemi Bankar dhe Luftimi i Informalitetit

²⁶ Strategjia Kombetare për zhvillim 2016-2021, fq 28

²⁷ Naim Huruglica (2017). Sistemi Bankar dhe Luftimi i Informalitetit

veçanta. Optimizimi i proceseve të mbledhjes së taksave duke i minimizuar burimet, eliminuar humbjet e fondeve dhe kursyer kohën. Më pas, ndryshimet e nevojshme ligjore për krijimin e administratës së unifikuar të mbledhjes së të hyrave. Procesi i shkrirjes së të dy institucioneve do t'i nënshtrohet një periudhe kalimtare, në mënyrë që organizatat të përgatiten për bashkim dhe të harmonizojnë proceset përkatëse.

- 5.) Themelimi i Agjencisë për mbledhjen e të hyrave. Hartimi i ligjit për themelimin e Agjencisë për mbledhjen e të hyrave, hartimi i planit të veprimit për funksionimin e agjencisë, si dhe kompletimi i operacionalizimit të Agjencisë për mbledhjen e të hyrave të Kosovës.²⁸ (SKRK)

Përgjatë tërë këtyre viteve, që nga themelimi i tyre, dy administratat kryesore përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve në Kosovë, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, kanë përmirësuar në vazhdimësi aftësitë e tyre në vjeljen e tatimeve në fuqi. Poashtu është përmirësuar dukshëm përgatitja profesionale e zyrtareve të të dyja agjencive, por edhe sistemet menaxhuese që ata përdorin, me qëllim të identifikimit dhe mbledhjes sa më të saktë të detyrimeve tatimore. Pavarësisht zhvillimeve pozitive, mbetet akoma shumë për të bërë dhe janë një varg aktivitete që rekomandohen për këto dy institucione, por edhe pjesën tjetër të shoqërisë, me qëllim të sigurimit të një sistemi sa më të mirë dhe sa më efikas tatimor:

Fiskalizimi, gjegjësisht detyrimi që çdo kompani ta lëshojë një kupon fiskal me rastin e kryerjes së një transaksioni shitjeje, është njëra ndër mënyrat për luftimin e informalitetit. Administrata Tatimore e Kosovës duhet të insistojë në fiskalizimin e plotë të ekonomisë dhe në zbatimin e saj praktik, e jo vetëm të mjaftohet me atë që kompanitë janë të pajisura me aparate fiskale.

“Dobësia” e këtij sistemi është se për të funksionuar duhet të ekzistojë edhe vullneti i atij që blen mallrat apo shërbimet për ta kërkuar kuponin fiskal. Duhet të vazhdohet të punohet me qytetarët për t'i “edukuar”, por edhe stimuluar, në zbatimin e drejtë të kësaj skeme kontrolli. Kjo siguron vjelje më të

²⁸ Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018

mirë të tatimeve, por edhe kursen shumë Administratën Tatimore, pasi një qytetar që kërkon kuponin fiskal për blerjet e tija e bën të panevojshme kontrollin tatimor ndaj atij subjekti.²⁹ (SKRK)

5.3 Përdorimi i parasë kesh dhe elektronike në Kosovë

Reduktimi i përdorimit të parave të gatshme në Kosovë ka qenë qëllim i tërë sektorit financiar në dekadën e fundit. Në bashkëpunim mes sektorit bankar dhe Bankës Qëndrore që në vitin 2011 janë bërë hapat e parë për reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme dhe për inkurajimin e përdorimit të formave elektronike të pagesave. Zhvillimi i teknologjisë digjitale, përmisimi i penetrimit me internet dhe paisje smart në tregun e Kosovës ju ka mundësuar bankave që të zhvillojnë dhe lancojnë instrumente të reja të pagesave elektronike. Infrastruktura bankare e shërbimeve të pagesave në Kosovë karakterizohet me një zhvillim të qëndrueshem, i prirë me rritje dhe zgjerim si në aplikim të teknologjisë innovative ashtu edhe në përdorim të instrumenteve elektronike.

Në Kosove viteve të fundit vërehet një rritje e përdorimit të instrumenteve elektronike për kryerjen e pagesave. Sipas revistes “The Kosovo Banker”, të dhënat e fundit statistikore, vërehet rritje në numër dhe vlerë të kredit transferave, të cilat paraqesin një alternativë për kryerjen e pagesave pa para të gatshme. Me rritje të dukshme të përdorimit janë karakterizuar edhe pagesat përmes instrumenteve elektronike siq janë: transaksionet përmes debit kartelave, kredit kartelat dhe e- banking, duke ndikuar në zvogëlim të pagesave në para të gatshme.

Aktualisht monedha e përdorur në Kosovë është Euro. BQK-ja është e obliguar me Ligjin për Bankën Qendrore “të sigurojë furnizimin e duhur me monedha dhe kartëmonedha për shlyerjen e transaksioneve në para”, gjë të cilën e bën duke ofruar tërheqje të keshit dhe lehtësira në depozita për konsumatorët e saj, kryesisht banka dhe duke transportuar monedha dhe kartëmonedha nga Eurozona. Si rezultat BQK eksporton më shumë para sesa që importon. Kërkesa kryesore për importim të parasë është në formën e kartëmonedhave me vlerë të vogël, zakonisht për përdorim në ATM, mbasi këto kartëmonedha vjetrohen shumë shpejt. Sistemi i pagesave në Kosovë karakterizohet nga mbështetja e vazhdueshme në paratë e popullatës. Me përjashtim të pagesave Kos-Giro (të cilat në çdo rast zakonisht paguhen në para), shumica

²⁹ Strategjia kombëtare e republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018

e pagesave ndërbankare të realizuara përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) iniciohen nga Qeveria apo entitetet tregtare.³⁰ (BQK)

Në vitin 2017 mbi 70% të pagesave që kalojnë përmes sektorit bankar kryhen përmes kanaleve elektronike (burimi). Pagesat që kryhen në sportelet e bankës dhe jo përmes kanaleve elektronike kryesisht janë: Xhiropagesat e Doganës, ndaj kompanive të Sigurimeve, ndaj operatorit të tretë në Kosovë. Procesimi i pagesave po bëhet gjithnjë e më i shpejtë, i lehtë, më pak i kushtueshëm, kryhet në kohë reale 24/7, si dhe kryhet me një komoditet të lartë.

Sipas një studimi të Capgemini dhe BPB Paribas të publikuar në vitin 2017, konsumatorët në mbarë botën pritet të kryejnë rreth 726 miliard transaksione përmes platformave digjitale të pagesave deri në vitin 2020. Në vitin 2016 Pro Credit Bank ka qenë banka e parë që ka sjellë në tregun Kosovar kartelat debit pa kontakt të markës Master Card Debit, ku mundësohen pagesa të shpejta dhe të lehta, në harmoni të plotë me zhvillimit dhe trendet ndërkombëtare në botë në fushën e pagesave.

Sipas studimit nga Moody's mbi ndikimet e pagesave elektronike në rritje ekonomike, i publikuar në vitin 2016, i cili e ka përfshirë kartat e debitit, kreditit dhe kartat me paragagim, ka paraqitur se rritja e pagesave elektronike ndikon direkt në rritjen e konsumit dhe produktit të brendshëm bruto. Për më tepër ky ndikim rritet vazhdimisht me rritjen e penetrimit të pagesave elektronike. Për të gjitha tregjet dhe ekonomitë e analizuara është vërejtur një korrelacion pozitivë ndërmjet përdorimit të kartelave dhe rritjes ekonomike. Nga ky studim është vlerësuar se me rritjen e pagesave elektronike rritet edhe eficiency ekonomike, pasi që zvogëlohen kostot e transaksioneve dhe përmisohet rrjedhja ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.³¹ (BQK)

Banka Qendrore e Evropës ka paralajmëruar se duke filluar nga pjesa e vitit 2018 do të ndalojë së emëtuarit 500 euro në mënyrë që të ndikojë në zvogëlimin e mundësisë dhe lehtësisë së përdorimit të parave të gatshme të vlerave të larta për kryerjen e transaksioneve. Katmonedhat 500 euro akuale, do të vazhdojnë të mbesin në qarkullim pa asnjë kufizim. Në Kosovë aktualisht, për sa i përket transaksioneve në para të gatshme ndërmjet bizneseve, Administrata Tatimore ka aplikuar kufizimin prej 500 eurove, përderisa nuk ka ndonjë kufizim për transaksionet ndërmjet personave fizik dhe bizneseve.

³⁰ <https://www.bqk-kos.org/repository/docs/2013/Buletini%20Informativ%20-%20Blue%20Book.pdf>

³¹ Intervistë e Guvernerit të BQK-së

Zvogëlimi i përdorimit të parasë së gatshme dhe rrjedhimisht zvogëlimi i ekonomisë jo-formale duhet të jetë strategji e nivelit kombëtar për të cilën duhet të angazhohen të gjitha institucionet e shtetit, megjithatë Banka Qëndrore si rregullator dhe mbikëqyrësi i vetëm i sektorit financiar, së bashku me bankat komerciale si akterët kryesor në ofrimin e shërbimit të pagesave, kanë një rol kyç në reduktimin e transaksioneve në para të gatshme.

Përfitimiet e përdorimit të transaksioneve elektronike do të jenë të mëdha si për shtetin, biznesin ashtu edhe për individin.³² (Interviste, SHBK)

Shteti - Tatimet që do të paguajnë bizneset do të ndihmojnë që të rritet kapitali i shtetit gjegjësisht të ndërtohet një infrastrukturë më e mirë e shtetit. Arsyejt e fitimit janë të shumfishta, në rradhë të parë fiton ekonomia e vendit dhe shoqëria e vendit pastaj dhe gjithë ata që i përdorin kartat bankare dhe po ashtu është një stabilitet për sektorin bankar.

Së pari përfiton ekonomia e shtetit përshkak se reduktimi i transaksioneve dhe kalimi në kartelat bankare ndikonë që të rritet prodhimi vendor dhe ulja e informalitetit. Po ashtu edhe studimet tregojnë që përdorimi i parasë së gatshme ka një kosto ekonomike dhe reduktimi i parasë së gatshme ndikon me një % në rritjen ekonomike të shtetit. Kjo është mënyra më e mirë që të kontribuojmë për shtetin duke e mbushur arkën e shtetit. Pra reduktimi i transaksioneve me kesh do të ndikojë drastikisht në mbushjen e arkës së shtetit.

Individet dhe bizneset - Përfitimet që do i kenë individët janë të shumfishta. Redukimi i transaksioneve përveç që do të ndikojnë në rritjen e arkës së shtetit kjo rrjedhimisht do të ndikojë drejtëpërsëdrejti tek qytetari. Ofron siguri më të madhe, shpejtësi dhe kosto më të ulët. Në këtë mënyrë çdo transaksion do të regjistrohet dhe individi do të ketë një pasqyrë të transaksioneve dhe në këtë mënyrë individi mundet të bëjë një analizë financiare dhe të shohim se sa kemi shpenzuar. Sistemet e zhvilluara të pagesave elektronike kanë ndikim të madh edhe në rritjen e transparencës dhe fuqizimin e mekanizmave të monitorimit të sistemeve të taksave. Rrjedhimisht reduktimi i informalitetit apo më mirë të thuhet evazioni fiskal do të ndihmojë që bizneset të paguajnë më shume tatime dhe kjo drejtëpërdrejtë ndikon në të mirë të shtetit.³³ (Reviste, TKB)

³² Intervistë me zyrtar të Bankave

³³ Revista, The Kosovo Banker (2017)- Reduktimi i transaksioneve me para të gatshme

5.4. Pagesat elektronike në Kosovë dhe vendet e rajonit

Valuta e përdorur në Kosovë është Euro. Seria e kartëmonedhave në qarkullim përfshinë shtatë denominime të ndryshme me vlera: 5 €, 10 €, 20 €, 50 €, 100 €, 200 € dhe 500 €. Monedhat në qarkullim janë: 1, 2, 5, 20 dhe 50 cent, dhe 1 € dhe 2 €. Një nga detyrat e BQK-së sipas Ligjit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, është të bëjë “sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Kosovë”³⁴. (BQK)

Kërkesa për para të gatshme nga ana e sektorit jo-bankar është rritur nominalisht gjatë viteve të fundit; por efektet sezonale shkaktojnë luhatje të konsiderueshme në përdorimin e parave të gatshme gjatë vitit. Mbajtja e parasë së gatshme nga publiku ndryshon dukshëm brenda muajit (në rritje në ditët që paguhen pensionet, pagat, etj.), dhe brenda vitit (qarkullimi i parasë së gatshme rritet shumë gjatë periudhës së verës dhe në fund të vitit, ndërsa zvogëlohet dukshëm në fillim të vitit dhe gjatë stinës së vjeshtës). Luhatjet brenda vitit mund të shpjegohen nga fluksi i emigrantëve që vizitojnë Kosovën gjatë intervaleve të ndryshme të vitit. Ata zakonisht sjellin një sasi të konsiderueshme të parave të gatshme me vete. Si rezultat, gjatë sezoneve të pushimeve ka një tepriçë neto të parave të gatshme, dhe BQK-ja eksporton më shumë se që importon monedha dhe kartëmonedha. Edhe pse instrumentet e reja të pagesave janë ofruar nga sektori bankar, sistemi i pagesave në Kosovë karakterizohet me një mbështetje të vazhdueshme të qytetarëve në pagesat me para të gatshme. Me përjashtim të pagesave Kos-Giro (një pjesë e madhe e të cilave paguhen në para të gatshme), shumica e pagesave ndërbankare përmes SEKN-së iniciohen nga institucionet qeveritare apo nga entitetet komerciale.

Gjatë vitit 2012 rreth 4.3 milionë transaksione me vlerë të përgjithshme prej 5.7 miliardë euro u kanalizuan përmes SEKN-së. Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 3.34 për qind dhe vlera e transaksioneve u rrit për 11.69 për qind. Vlera ditore e transaksioneve të SEKN-së në vitin 2012 ishte 22.9 milionë euro, krahasuar me rreth 20.5 milionë euro në vitin 2011.

³⁴ Ligji Nr. 03/L-209 "Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", Kreu III, Neni 8.1.1.4.

BQK si pronare dhe operatore e SEKN-së, ka vendosur tarifat për ofrimin e shërbimeve të pagesave që ofron ky sistem²⁰. Këto tarifa kategorizohen në këto kategori të mëposhtme: tarifa për kyçje për pjesëmarrës të ri, tarifa mujore për mirëmbajtje të lidhjes telekomunikuese, tarifa për raporte të veçanta, dhe tarifa për transaksione. Çmimi për një transaksion ndryshon varësisht nga lloji i pagesës dhe sesioni që klirohet: çmimet janë më të larta për sesionet e paraditës, ndërsa më të ulëta për sesionet e pasdites. Pagesat prioritare lirohen një nga një në baza bruto, jo me vonë se 15 minuta pas pranimit të tyre, nga ora 8:00 deri në ora 15:45. Ka tarifa për kyçje për pjesëmarrës të ri, por nuk ka tarifa vjetore anëtarësimi për pjesëmarrësit ekzistues. Pjesëmarrësit paguajnë çdo muaj një tarifë minimale për mirëmbajtje të lidhjes telekomunikuese. Politika e BQK-së për vendosjen e çmimeve për shërbimet e SEKN-së bazohet në parimin e kthimit të plotë të shpenzimeve, pra qëllimi nuk është profiti. Tarifat shqyrtohen kohë pas kohe nga BQK në bazë të kësaj politike. Në këtë mënyrë BQK synon të ndihmojë sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi, duke ofruar tarifa të ulëta që promovojnë përdorimin e instrumenteve të pagesave jo në para të gatshme.

Në ndër platformat më të njohura deri më tash në Kosovë është platforma digjitale/ elektronike e quajtur e-Banking. Integrimi i kartelave në e-banking dhe shfrytëzimi i tyre për pagesa direkte është një hap me shumë për të u ofruar versionet e ashtuquajtura ‘digital wallet’ të cilat ofrohen nga kompanië e fuqishme të teknologjisë.

Për pagesat fizike tek pikat e shitjes (POS) janë të njohura metodat standard të pagesave me kontakt, por edhe ato pa kontakt.

Contactless- pagese pa kontakt përmes katelës, apo ‘stikereve ‘ të vendosur në telefon. Sipas statistikave, numri i terminaleve të cilat pranojnë pagesa pa kontakt në Kosovë ka kaluar numrin 1000.

Tashmë në Kosovë ka kompani të specializuara në aspektin e teknologjisë informative dhe specifike për sektorin bankar. Kompania Quipu SHPK e cila vepron në Kosovë për një kohë të gjatë, duke ofruar shërbime të ndryshme bankare dhe njëkohësisht duke ju lehtësuar përgatitjen e platformave edhe për pagesa digjitale. ³⁵ (Revista, TKB)

³⁵ Revista, The Kosovo Banker (2017) – Trendet, ndryshimet dhe rritja e pagesave përmes platformave digjitale

Një shembull tjetër i suksesshëm i përdorimit të pagesave digjitale, dhe në veçanti i pagesave me kartela në Evropë është shteti i Danimarkës. Ku në viti 2016, 81% e pagesave në ekonominë Daneze bëhen me kartelë, dhe Danimarka është vendi i parë në BE me % të lartë të pagesave me kartela, kur mesatarja e shteteve të Bashkimit Evropian është 49%. Çdo danez e përdor kartelën mesatarisht 330 here në vit.³⁶ (Revista, TKB)

6. Përfundimet

Ky punim trajton rëndësitë e reduktimit të transaksioneve me para të gatshme në ekonominë vendore, mundësitë dhe kufizimet gjatë aplikimit të metodave të ndryshme të transaksioneve elektronike brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu paraqet vështrimin kritik nga njohuritë e fituara gjatë studimeve si dhe gjatë përpilimit të punimit.

Siç u përmend më lart, teknologjia po ndryshon dhe do të ndryshojë gjithçka. Ajo po kthehet në një faktor të pamohueshëm të rritjes së cilësisë së shërbimit për klientë, si dhe për uljen e shpenzimeve të të bërit biznes. Inovacioni është i domosdoshëm, i pashmangshëm. Ritmi i këtyre ndryshimeve që vijnë si rezultat i teknologjive të reja digjitale është në rritje të pandalshme, dhe bankat nuk kanë zgjidhje përveç të sigurohen që po pozicionohen me sukses për një të ardhme më të sigurt. Ndikimi i tij në industrinë financiare është transformues: ai shkon shumë më thellë se mundësia për të optimizuar dhe kursyer prej adaptimit të inovacioneve në teknologjinë informative.

Konsumatorët janë një nga faktorët kryesorë që kanë përshpejtuar nevojën për digjitalizim e pagesave dhe redukimin e keshit. Ata janë pararoje në adaptimin e teknologjive, kanë pritje për shërbime të unifikuara dhe globale, dhe gjykojnë për përvojat e tyre bazuar në: sa bankat i plotësojnë nevojat e tyre; sa është e lehtë të kryejnë shërbimin dhe sa janë të kënaqur me shërbimet që marrin. Rrjedhimisht, bankat do të kenë vazhdimisht sfidën e përshtatjes së modeleve të tyre ekzistuese me këto kërkesa të reja dhe në rritje të klientëve.

³⁶ Revista, The Kosovo Banker (2017)- Platformat digjitale te pagesave dhe zëvendësimi I parasë së gatshme

Sot bankat në Kosovë i ofrojnë klientit fleksibilitet 24/7, shpejtësi, bankim online (E-Banking) mundësi zgjedhje në kanalin e shërbimit më të përshtatshëm, pavarësim nga vizita e domosdoshme në degë, komoditet, qasje globale (pagesa në bankomate nëpër botë, blerje në internet, kryerje e shërbimeve gjatë udhëtimeve), duke redukuar në masë të madhe përdorimin e pagesave kesh.

Bazuar në të dhënat informaliteti në Kosovë është rreth 31.7 %. Informaliteti është një nga dëmtuesit më të mëdhenjë të ekonomisë së një shteti. Punësimi informal në Kosovë është më i lartë se në shumicën e shteteve të BE-së. Informaliteti në Kosovë vlerësohet të jetë veçenarisht i lartë në bujqësi dhe ndërtimtari, sektorët ku punët kanë tendencë të kërkojnë personel më pak të kualifikuar, punë rastësore dhe - në rastin e bujqësisë - të pa paguara punëtorët e familjes. Gjithashtu, bizneset e vogla dhe të mesme janë në gjendje të involvohen në evazion fiskal më tepër sesa bizneset e mëdha. Sipas disa të dhënave të publikuara, vlerësohet se së paku 30% e aktiviteteve biznesore nuk raportohen për qëllime tatimore. Po ashtu vlerësohet se edhe tregu informal i punës vazhdon të jetë i lartë, duke vazhduar ta punësojë një numër të madh të punëtorëve të peregjistruar dhe të padeklaruar për qëllime tatimore. Sipas këtyre të dhënave besohet se informaliteti është i shfaqur në shumë mënyra, qoftë përmes kontrabandimit të mallrave përmes kufijve, duke shmangur deklarin e saktë të sasisë, vlerës dhe prejardhjes së mallrave para autoritetit doganor në Kosovë, ose edhe përmes mosdeklarimit të aktiviteteve ekonomike brenda vendit, siç janë: fshehja e transaksioneve reale, mosdeklarimi i shitjeve të mallrave dhe shërbimeve, mosdeklarimi i saktë i numrit dhe pagave reale të punëtorëve të angazhuar, etj.

Transaksionet elektronike konsiderohet se mund të ndihmojnë në luftën kundër informalitetit. Momentalisht, diku rreth 90% të shërbimeve bankare në disa banka në Kosovë, raportohen se kryhen përmes shërbimeve elektronike. Përfitimet e pagesave elektronike janë të shumëfishta. Në rradhë të parë fiton ekonomia e vendit dhe shoqëria e vendit pastaj dhe gjithë ata që i përdorin kartat bankare dhe po ashtu është një stabilitet për sektorin bankar. Përfiton ekonomia e shtetit përshkak se reduktimi i transaksioneve dhe kalimi në kartelat bankare ndikonë që të rritet prodhimi vendor dhe ulja e informalitetit. Po ashtu edhe studimet tregojnë që përdorimi i parasë së gatshme ka një kosto ekonomike dhe reduktimi i parasë së gatshme ndikon me një % në rritjen ekonomike të shtetit. Sistemet e zhvilluara të pagesave elektronike kanë ndikim të madh edhe në rritjen e transparencës dhe fuqizimin e mekanizmave të monitorimit të sistemeve të taksave. Rrjedhimisht, reduktimi i informalitetit apo më mirë të thuhet evazioni fiskal do të ndihmojë që bizneset të paguajnë më shumë tatime dhe kjo drejtëpërdrejtë ndikon në të mirë të shtetit.

Nga të dhënat e prezantuara më lartë konstatohet se nga të gjitha grup-moshat, meshkujt janë ata të cilët bëjnë më shumë blerje “online”. Vlera e transaksioneve “online” të kryera nga klientët e moshës 26-35 vjeç dhe ata të moshës 36-45 vjeç ka pjesëmarrjen më të madhe në vlerën e përgjithshme të blerjeve “online”. Në grup-moshën 26-35 vjeç 73 % e blerjeve “online” janë kryer nga ana e meshkujve ndërsa 27 % nga femrat. Dallimi gjinor më i madh është në grup-moshën +55 vjeç, ku nga vlera e përgjithshme e blerjeve “online” me kartela, 88 % e tyre është kryer nga meshkujt.

7. Rekomandimet

Sfidë e sektorit bankar në Kosovë në redukimin e keshit mbetet përdorimi i shërbimeve elektronike bankare nga klientët. Bankat duhet të përmirësojnë përvojën dhe eksperiencën e klientëve në përdorimin e kanaleve të shumëfishta të shitjes. Ato në mënyrë proaktive duhet të inkurajojnë përdorimin më masiv të shërbimeve dhe pagesave elektronike. Në këtë kontekst bankat mund të përdorin disa mekanizma për të inkurajuar sjelljen konsumatore, duke filluar prej nxitjes përmes çmimeve më të favorshme të shërbimeve bankare elektronike, dhe më pas përmes informimit dhe edukimit të vazhdueshëm të klientëve mbi mënyrën e përdorimit si dhe mbi avantazhet e shërbimeve elektronike bankare. E fundit, bankat duhet të risin edhe më tej infrastrukturën e sigurisë ndaj sulmeve kibernetike, si dhe edukimin e vazhdueshëm të klientëve ndaj rreziqeve që vijnë prej përdorimit të teknologjive digjitale.

Në fund, bankimi digjital si një model i ri biznesi, i ofruar përmes kanaleve të shumëfishta dhe të integruara të shërbimeve bankare elektronike është e ardhmja e çdo sektori bankar në një shekull kur inovacioni teknologjik nuk njih kufij. Duke pasur parasysh numrin relativisht të lartë të kartelave në qarkullim si dhe rrjetin e terminaleve ATM dhe POS, institucionet duhet të koncentrohen më shumë në rritjen e përdorimit të kartelave të cilat tanimë janë të shpërndara te qytetarët, por që përdorimi i tyre në terminale të pagesave mbetet i ulët. Inkurajues është fakti se qytetarët po i përdorin kartelat edhe për kryerjen e transaksioneve me vlera te vogla të cilat paraqesin pagesa të përditshme, që zakonisht janë në numër të madh. Kryerja e këtyre pagesave me anë të kartelave do të ndikojë në zvogëlimin e qarkullimit të parasë së gatshme duke zvogëluar shpenzimet operative të ndëlidhura me qarkullimin e tyre.

Krahas zhvillimit të fushatave edukative për përdorimin e instrumenteve elektronike për pagesa, institucionet financiare duhet të bëjnë vlerësimin e rezultateve të këtyre fushatave, duke analizuar dhe matur rezultatet e arritura gjatë fushatave të tilla. Institucionet financiare duhet të ofrojnë tarifa më të volitshme për qytetarët të cilët kryejnë pagesa me kartela, po ashtu edhe për kompanitë të cilat pranojnë kryerjen e pagesave përmes kartelave. Në këtë mënyrë qytetarët dhe bizneset do të nxiten për përdorimin e kartelave për kryerje të pagesave dhe redukimin e pagesave me para te gatshme.

8. PRAKTIKË

8.3. Fushata: Reduktimi i transaksioneve me para të gatshme në Kosovë

Shoqata e Bankave të Kosovës ka organizuar një fushatë informuese për popullin e gjërë në lidhje me reduktimin e parasë së gatshme. Fushata ishte e organizuar dy muaj rradhazi në bashkëpunim me bankat komerciale si dhe e mbështetur nga shoqatat e pagesave VIZA dhe MASTERCARD.

Fushata ka pas për qëllim sensibilizimin e publikut të gjërë në Kosovë për rëndësinë e zëvendësimit të transaksioneve me para te gatshme në transaksione në kartat bankare të debitit.

Reduktimi i transaksioneve me para të gatshme do të ofrojë shumë benefite jo vetëm për qytetarin e Kosovës mirpo për tërë ekonominë e Kosovës. Reduktimi i keshit pra zëvendësimi i transaksioneve me kartela bankare dhe shërbimet tjera elektronike siq është online e-banking nuk është benefit vetëm për banka mirpo vërtetë i ndihmonë strukturtës së ekonomisë së Kosovës.

Reduktimi i informaliteti apo më mirë të thuhet evazioni fiskal do të ndihmojë që bizneset duhet të paguajnë tatimet.

Kampanja ka pas për qëllim se me rastin e përdorimit të kartave bankare në përveq që do bëjmë një shërbim me të lehtë ne do i ndihmojmë në rritjen e buxhetit të shtetit.

Pagesa me kartelë është një shprehi e mire!³⁷

³⁷ Shoqata e Bankave të Kosovës. (2017-2018) <https://www.bankassoc-kos.com/>

Literatura

- Ashike, H. (2011). Cashless Economy can Reduce Risk of Carrying Huge Cashl, [Online] E çasshme në: <http://www.businessdayonline.com/.../22217>
- Abdixhiku, L. Pugh, G. and Hashi I. (2013). Determinants of Business Tax Evasion in Transition Economies: A Panel Investigaiton. Working Paper
- Albanian Center for Economic Research (1999). Informal Economy in Albania: Study of Hidden Employment and Tax Evasion, ACER.
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) (2018). Raporti Vjetor 2017
- Agjensia Kosovare e Biznesit (AKB) (2017) Ekonomia informale dhe tranzicioni drejt ekonomisë së tregut. fq 12
- <http://economictimes.indiatimes.com/wealth/spend/going-cashless-is-it-good-for-you/articleshow/55908649.cms>
- Malaj, A. (2016). Formalizimi i Ekonomisë. Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje. fq 44
- Instituti Riinvest (2013). Të pagush apo të mos paguash, Informaliteti nga kendveshtrimi i bizneseve në Kosovë.
- Naim Huruglica (2017). Sistemi bankar dhe luftimi i informalitetit
- Revista “The Kosovo Banker (Kosovo Banking Association)
- Revista “Bankieri” (Albanian Association of Banks)
- Shtojca IBANK” Digjitalizimi Bankar në hap me Evropën”
- Strategjia Kombetare për zhvillim 2016-2021.
- World Bank Document (2017). Jobs Diagnostic Kosovo. Issue No. 5. E çasshme në: <http://documents.worldbank.org/curated/en/814361497466817941/pdf/ACS21442-WP-PUBLIC-ADD-SERIES-KosovoJDWEB.pdf>

Burimet online:

www.bqk-kos.org ; www.bankassoc-kos.com

www.bankofalbania.org ; www.visaonline.com ; www.mastercardconnect.com